



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:007542
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05504831
Ac.nr.4854/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislímaj, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestuese të paditësit N. R. nga fshati K., Komuna e Vitisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. M. M. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. B... D. nga Gjilani, me objekt kontesti pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesave të paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1053/2021 i datës 16.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesat e paditësit N. R. nga fshati K..., Komuna e Vitisë dhe të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1053/2021 i datës 16.05.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.1053/2021 i datës 16.05.2022, ka vendosur si në vijim: **I.** Aprovohet në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit N. R. nga fshati K..., K. e Vitisë dhe vërtetohet se e paditura Komuna e Gjilanit, më dt. 16.11.2015, e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe faktik të posedimit të pjesës së ngastrës kadastrale P-.....-0.-0, e cila gjendet në vendin e quajtur “D.” ZK. Gjilan, në sipërfaqe prej ... m², me përmasa dhe kufijtë: nga ana jugore, në gjerësi prej 5.8 metra, ana lindore, thyerja e parë, në gjatësi prej ...02 metra, thyerja e dytë, në gjatësi prej65 metra, pastaj kthesa e imët nga pjesa lindore, në gjatësi prej 0.64 metra, nga ana veriore, në gjerësi 4.4 metra dhe nga ana perëndimore, thyerja e

parë, në gjatësi prej 17.4 metra dhe thyerja e dytë, në gjatësi prej 3.87 metra, si dhe në pjesën e parcelës P-.....-.....-0, në anën jugore, në gjerësi prej 5.7 metra, në anën lindore, në gjatësi prej 20.2 metra, në anën perëndimore, në gjatësi prej 20.4 metra dhe në anën veriore, në gjerësi prej 5.8 metra, në atë mënyrë që pa shpalljen e interesit të përgjithshëm, pa bazë juridike e në mënyrë arbitrare, ka hapur një rrugë të cilën e ka mbushur me zhavorr, duke ia ndarë të dy parcelat në nga dy pjesë, me çka paditësit i ka pamundësuar shfrytëzimin e lirë dhe të qetë faktik të pjesëve të lartcekura të këtyre ngastrave.

II. Urdhërohet e paditura Komuna e Gjilanit, që të kthejë gjendjen e mëparshme të posedimit, në atë mënyrë që të mënjanojë zhavorrin e hedhur dhe t'i mundësojë paditësit shfrytëzimin e lirë të ngastrave të tij dhe në të ardhmen të përmbahet dhe mos ta pengojë paditësin në mënyrë të njëjtë apo të ngjashme në shfrytëzimin e lirë dhe të qetë të këtyre paluajtshmërive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën pasojat e përbarimit të dhunshëm ligjor.

III. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 1,432.50€, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën pasojat e përbarimit të dhunshëm ligjor. Pjesa tjetër e kërkesave në lartësi prej 1,028.50€, të kërkuara ma tepër se shuma e gjykuar, refuzohen si të pabazuara.

Kundër këtij aktvendimi, e paditura, në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta ndryshojë duke ia refuzuar kërkesëpadinë e paditësit ose të njëjtën ta anulojë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi, në afatin e paraparë ligjorë ka ushtruar ankesë kundër vendimit mbi shpenzimet e procedurës, duke propozuar që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar dhe të miratohet në gjitha shpenzimet e kërkuara nga paditësi.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimit e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, avokatit M. M. nga Gjilani, në gjykatën e shkallës së parë, me datë 19.11.2015 ka parashtruar padi për shkak të pengim posedimit kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, kërkesë të cilën e ka rregulluar në shqyrtimin kryesorë të datës 16.05.2022 me propozim që e njëjta të aprovohet dhe të obligohet e paditura në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave ka nxjerrë aktvendimin C.nr.822/2015 i datës 21.01.2020, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të të njëjtit.

Paditësi, kundër këtij aktvendimi në afatin e paraparë ligjorë ka ushtruar ankesë për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta ndryshojë duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ose të njëjtën ta anulojë dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Gjykata e Apelit duke vendosur në ankesën e paditësit, me aktvendimin AC.nr. 2925/2020 i datës 12.07.2021, ka aprovuar ankesën e paditësit dhe e ka anuluar aktvendimin e ankimuar C.nr. 822/2015 i datës 21.01.2020 dhe çështja është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Në ri gjykim, Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse si dhe administrimit të provave ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar C.nr.1053/2021 i datës 16.05.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka arsyetuar se: Gjykata, me rastin e vendosjes meritore të çështjes kontestimore ka pasur parasysht nenin 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), ku përcaktohet se *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit”*: Andaj, edhe është kufizuar vetëm në gjendjen e fundit faktike para pengim posedimit, kohën e pengim posedimit dhe mënyrën e pengimit.

Më tej ka arsyetuar se: Mes të palëve nuk është kontestues fakti se e paditura me datën 16.11.2015, ka hapur rrugë në parcelat e paditësit dhe se këtë rrugë e ka shtruar me zhavor, ashtu që paditësi me t'u kthyer nga bota e jashtme ku punon dhe jeton, pra me datën 16.11.2015 ka konstatuar hapjen e rrugës në këto parcela që janë në pronësi dhe posedim të tij dhe se me datë 19.11.2015 ka ushtruar padi ndaj të paditurës për shkak të pengim posedimit, ngase këto fakte nuk i ka kundërshtuar e paditura, meqë të njëjtat konfirmohen nga Kontrata për Shitblerjen e Paluajtshmërisë VR.nr. .../09 e datës 12.08.2009 dhe se kjo kontratë është zbatuar në DGJKP në Gjilan, ku paditësi në bazë të Certifikatës mbi të drejtat pronësore me numër të lëndës 10746-2015, është regjistruar si pronarë i vetëm i paluajtshmërive.

Më tej ka theksuar se: Në fakt e paditura Komuna e Gjilanit, me datën 28.09.2010 ka aprovuar Vendimin nr. 01-.....9, për miratimin e Planit Rregullues Urban “ Fidanishte” e Qytetit të Gjilanit, i cili plan ka përfshirë hapësirën/ trekëndëshin/ e rrugës magjistrale Gj...-B., duke filluar nga U... mbi lumin St...., përballë Kazermës së TMK-së, tani FSK-së, duke vazhduar në drejtim të Bujanocit, deri te bashkimi i rrugës unazore me rrugën magjistrale përballë kufirit të Fabrikës për përpunimin e metaleve “Q.....” dhe Fabrikës së baterive NI-CD, në Gjilan dhe kthehet në anën e majtë me të lagjes “Dh...i B..” dhe se ngastrat kadastrale të përfshira në këtë plan shpallen në interesin e përgjithshëm publik, por që sipas gjykatës nuk ka të theksuara në këtë plan se a janë përfshirë edhe parcelat e paditësit, pasi që edhe nga vet procesverbali nr. 07-....-....., i datës 30.06.2016, me rastin e takimit publik për dëgjimin e kërkesave të pronarëve të parcelave të përfshira në këtë plan, nuk ka të evidentuar se cilat parcela janë përfshirë në këtë plan si dhe faktin se paditësi askund nuk figuron si pjesëmarrës i takimit dhe se nuk ka dokumente publike lidhur me shpronësimin eventual të tyre apo marrjen e vendimit përfundimtar të shpronësimit konform 11 dhe 12 si dhe nenit 25 dhe 26 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës / Ligji nr. 03/L-205, i datës 28 tetor 2010/ që kanë të bëjnë me vendimin përfundimtar, fitimin e posedimit dhe kalimin e pronësisë në të paditurën, apo së paku e paditura nuk ka arritur që me dokumente publike të vërtetoj këto fakte në mënyrë që të konstatohet se ka qenë në posedimin e pasurisë së shpronësuar dhe me këtë të konfirmohet fakti se veprimet e ndërmarra nga ana e saj nuk përbëjnë pengim posedim, ngase janë marr në interesin e përgjithshëm publik dhe konform procedurave ligjore të shpronësimit, e këtë detyrim e paditura e ka pasur në bazë të nenit 322.3 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”* Andaj, në mungesë të këtyre provave materiale, gjykata konstaton se e paditura nuk ka qenë fare në posedimin e parcelave të paditësit dhe se hapja e rrugës në parcelat e paditësit përbëjnë veprime arbitrare të cenimit arbitrar të pronës së huaj dhe të pengim posedimit, ngase veprimeve të tilla iu mungon baza juridike dhe se paditësi si posedues me mirëbesim i paluajtshmërive gëzon mbrojtje gjyqësore nga veprimet e të tjerëve, konform nenit 113 të LPTDS/ Ligji nr. 03/ L-154 25 qershor 2009/ ku përcaktohet se *“ Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit.”*

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata me qëllim të përcaktimit të vëllimit të pengimit në posedim të parcelave përkatëse, ka dalur në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertin gjeodet B.. K., i cili në konstatimet e tij të dhënë në ekspertizë të datës 10.02.2022 së bashku me skicën e matjeve nga vendi i ngjarjes si dhe plotësimet e tij gjatë seancës kryesore, ka theksuar se rruga e shtruar me zhavorr, e hapur nga e paditura Komuna e Gjilanit, kalon përmes ngastrës P-70403013-.....-0, me përmasa dhe kufijtë: nga ana jugore, në gjerësi prej 5.8 metra, ana lindore, thyerja e parë, në gjatësi prej02 metra, thyerja e dytë, në gjatësi prej 3.65 metra, pastaj kthesa e imët nga pjesa lindore, në gjatësi prej 0.64 metra, nga ana veriore, në gjerësi 4.4 metra dhe nga ana

perëndimore, thyerja e parë, në gjatësi prej 17.4 metra dhe thyerja e dytë, në gjatësi prej ..87 metra, si dhe ngastrës P-.....-.....-0, me përmasa dhe kufijtë: në anën jugore, në gjerësi prej7 metra, në anën lindore, në gjatësi prej2 metra, në anën perëndimore, në gjatësi prej 20.4 metra dhe në anën veriore, në gjerësi prej 5.8 metra, e që këto fakte janë vërtetuar edhe me shikimin e gjykatës në vendin e ngjarjes, ku gjykata ka konstatuar se vërtetë nga e paditura është hapur rrugë për kalim e shtruar me zhavor, e cila i ndanë në dy pjesë parcelat e paditësit, andaj, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke i urdhëruar të paditurës që të kthejë gjendjen e mëparshme të posedimit, në atë mënyrë që të mënjanojë zhavorrin e hedhur dhe t'i mundësojë paditësit shfrytëzimin e lirë të ngastrave të tij dhe në të ardhmen të përmbahet dhe mos ta pengojë paditësin në mënyrë të njëjtë apo të ngjashme në shfrytëzimin e lirë dhe të qetë të këtyre paluajtshmërive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Më tej ka shtuar se: pretendimet e të paditurës, se veprimet e ndërmarura janë kryer në baza ligjore nuk kanë mbështetje ligjore, me arsyetimin se nuk është e mjaftueshme që në bazë të një plani rregullativ të fitohet edhe e drejta e posedimit, pa pasur vendim përfundimtar të shpronësimit konform Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe se e paditura, respektivisht organi i saj, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit në përgjegjëjen ndaj kërkesës së gjykatës me numër reference 02-...-1.... e datës 11.11.2016 nuk ka dhënë ndonjë argument apo provë materiale me të cilën do ta kundërshtonte posedimin e qetë të paditësit në këto paluajtshmëri, por vetëm ka cituar se paraqitja grafike e planit rregullativ është bërë me datën 11.11.2016 dhe se rruga është shtruar me zhavor në vitin 2016, pasi që gjykata me kërkesë kë kërkuar saktë datën e hapjes së rrugës e jo edhe të shtrimit të zhavorit.

Lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat e nenit 113 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore si dhe nenin 480 të LPK-së.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, përfundim e Gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm, për faktin se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, për të cilat gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e as në shkeljet në të cilat thirret pala me ankesë, e gjithashtu është vërtetimit të drejtë dhe të plotë edhe gjendja faktike.

Gjykata e Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së. Dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i qartë dhe në pajtim me arsyetimin, gjykata ka paraqitur arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me posedimin dhe pretendimet e paditësit për aktin e pengimit të posedimit. Në kontestet e pengimit të posedimit gjykata është e obliguar të provoj faktet lidhur me gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara është vërtetuar se në rastin konkret paditësi

është posedues i fundit i ngastrës lëndore dhe është vërtetuar akti i pengim posedimit në ngastrën lëndore, në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike nga provat e administruara, më të cilat është vërtetuar akti i pengim posedimit, ku e paditura e ka penguar paditësin në shfrytëzim dhe posedim të ngastrës lëndore, në atë mënyrë që më dt. 16.11.2015, e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe faktik të posedimit të pjesës së ngastrës kadastrale P-.....-.-....., e cila gjendet në vendin e quajtur “D.” ZK. Gjilan, në sipërfaqe prej ... m², me përmasa dhe kufijtë të përcaktuar si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të plotë nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore. Andaj, këto veprime të ndërmerrura nga e paditura janë pengesë që paditësi të posedoj në mënyrë të lirë dhe të qetë paluajtshmërit në fjalë, pasi që veprimet e të paditurës kanë qenë arbitrare dhe jo të bazuara në dispozita konkrete ligjore dhe kanë penguar paditësin shfrytëzimin e parcelave kontestuese, fakti se e paditura kishte nxjerrë Vendimin nr. 01-....., për miratimin e Planit Rregullues Urban “ F.” e Qytetit të Gjilanit, i cili plan ka përfshirë hapësirën/ trekëndëshin/ e rrugës magjistrale Gj....-B....., duke filluar nga Ura mbi lumin S...., përballë Kazermës së TMK-së, tani FSK-së, duke vazhduar në drejtim të Bujanocit, deri te bashkimi i rrugës unazore me rrugën magjistrale përballë kufirit të Fabrikës për përpunimin e metaleve “Q.” dhe Fabrikës së baterive NI-....., në Gjilan dhe kthehet në anën e majtë me të lagjes “Dheu i Bardhë” dhe se ngastrat kadastrale të përfshira në këtë plan shpallen në interesin e përgjithshëm publik, nuk e bënë të paditurën pronarë të këtyre paluajtshmërive e as posedues, pasi që e njëjta duhet të ndërmerr veprimet për shpronësim të paluajtshmërive dhe më pastaj të nisë zbatimin e planit urbanistik.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuar pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur është mbështetur në nenin 113 të LPTDS/ Ligji nr. 03/ L-.... 25 qershor 2009/ ku përcaktohet se “ *Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit.*”, ndërsa sipas nenit 480 të LPK-së, i cili parasheh që “*Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit*”. Sipas nenit 103 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, përcakton se: “*Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë*”. Neni 107 paragrafi 1 i LPDTS-së, përcakton se: “*Posedimi nuk shuhet si rezultat i moslejimit të poseduesit për ushtrimin e kontrollit mbi sendin në një kohë të përkohshme*”. Sipas dispozitës së nenit 111 paragrafi 1 të LPDTS parashihet se: “*Personi i cili e privon nga posedimi*

poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj”. Andaj, në rastin konkret e paditura ka vepruar në mënyrë arbitrare në rregullimin e rrugës me zhavorr në parcelat e paditësit, kjo për faktin se edhe vet e paditura gjatë shqyrtimin kryesorë ka theksuar se kjo zonë me vendim administrativë është shpallur zonë me interes publik, por e njëjta ka dështuar që ti ndërmarrë veprimet ligjore për të shpronësuar pronarët e paluajtshmërive që gjinden në atë pjesë të zonës. Andaj, e paditura mund të ndërmarrë veprime konkrete në parcelat e paditësit vetëm pasi ti ketë kryer procedurat ligjore për de posedim të paditësit nga kjo pjesë e paluajtshmërisë e kjo mund të ndodhë duke u bazuar në dispozita konkrete ligjore.

Në rrethana të tilla rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me gjendjen e fundit të posedimit dhe pretendimit për aktin e posedimit, ku mbi këtë bazë nga provat e administruara ka nxjerr përfundimin e drejtë se paditësi është penguar nga i padituri në posedimin e lirë dhe të qetë të ngastrës lëndore, prandaj edhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit i analizoj pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me shpenzimet e procedurës dhe vlerëson se të njëjtat pretendime janë të pa bazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur në lidhje me shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime të krijuara në këtë procedurë dhe kanë qenë të domosdoshme për zhvillimin e kësaj procedure e të cilat janë edhe në proporcion edhe me tarifën e OAK-së. Ndërsa pjesa e shpenzimeve të kërkuara nga paditësi në lidhje me shpenzimet e krijuara në procedurë përmbartimore, janë shpenzime të krijuara në një procedurë tjetër dhe nuk mund të obligohet e paditura në këtë procedurë, pasi që edhe ligji i Procedurës Përmbartimore e rregullon çështjen e shpenzimeve të procedurës dhe paditësi në atë procedurë është dashur ti kërkoj dhe jo në këtë procedurë kontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i vlerësoi pretendimet tjera ankimore të paditurit dhe gjen se janë të pathemelta dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë, andaj në kuptim të nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4854/2022, me datë 25.03.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v